

VETË – EVALUIMI

Само - евалуација

SH.F.K “**FAN NOLI**”

ООУ “**Фан Ноли**”

2020/21--2021/2022



Декември 2020
с. Требош

Dhjetor 2020
f. Trebosh

Periudha – Период	2020/21--2021/22
Lloji shkollës – тип на училиште	Shkollë fillore komunale – ООУ
Themelues i shkollës – Основач на училиште	Komuna e Zhelinës
Gjuha mësimore – наставен јазик	Gjuha shqipe
Adresa e shkollës – Адреса на училиштето	F. Trebosh
Telefoni - тел	044-368/500 075 – 451-302
e-mail - емајл	sh-fan.noli@hotmail.com

RAPORT NGA VETË-EVALUIMI I SHKOLLËS РАПОРТ ОД САМО ЕВАЛУАЦИЈА

Të dhënat identifikuese për shkollën

Emri i shkollës	”Fan Noli”			
Vendndodhja e shkollës	Selia f. Trebosh			
Kontakt informatat	044 - 368/500	sh-fan.noli@hotmail.com		
	075 – 451-302	sh-fan.noli@hotmail.com		
Kryetari i Këshillit të shkollës	Izair Saiti			
Drejtori i shkollës	Remzi Rexhepi			
Shkalla e shkollës	Fillor			
Numri i nxënësve në vitin shkollor 2019/2020				
Numri i të punësuarëve	Arsimtar	Bashkëpunëtor profesional	Punëtor administrativ	Gjithsej
		2	1	

Specifikat e shkollës	Shkolla qendrore e plotë me nga dy paralele Shkollat periferike të plota me nga dy paralele Shkollat periferike të plota me nga një paralele I-V
-----------------------	--

EKIPI I VETË EVALUIMIT

Emri dhe mbiemri	Funksioni në shkollë
Shehida Misimi	Pedagoge
Semira Esati	Psikologe
Rahim Fazlija	Arsimtar
Berzat Sadiki	Arsimtar
Festim Zulfuari	Arsimtar

KOORDINATOR I EKIPIT PËR VETË EVALUIM

Emri dhe mbiemri	Semira Esati	Rahim Fazlija
Funksioni në shkollë	Psikologe	Arsimtar
Telefon	070-286-825	
E-mail adresa	semira.muharemi88@gmail.com	

REZIME NGA VETË-EVALUIMI I REALIZUAR

Në bazë të nenit 129, alineja 1,2,3,4 nga Ligji për arsimin fillor (Fleta zyrtare e RM nr..103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11 , 06/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 67/17, dhe 64/18), Komisioni për përgatitjen e vetëevaluimit të punës e SHFK “**Fan Noli**”-f.Trebosh, për periudhën prej vitit 2020 deri 2023 realizoi vetëevaluimin e punës në shkollë.

Procesi i vetevaluimit për këtë vit mësimor ka filluar me caktimin e komisionit për evaluim, i cili formohet në mbledhjen e Këshillit të arsimtarëve të mbajtur më **30.08.2020** në këtë përbërje: Shehide Misimi (pedagog), Semira Esati (psikolog), Rahim Fazlija (arsimtar), dhe Festim Zulfuari (arsimtar) Berzat Sadiki (arsimtar). Ky komision mbajti takimin e parë me datë **22.10.2020** dhe mori detyra konkrete për realizimin e vetëevaluimit në tërësi për vitet paraprake..

Gjatë punës, ekipi kishte takime dhe biseda me të gjithë anëtarët e komisioneve të caktuara për çdo lëmi të vetëevaluimit si dhe u vendos që të gjitha projektet që janë realizuar nga ana e arsimtarëve gjatë këtyre dy viteve të përpunohet dhe të shtohen në planin zhvillimor i shkollës.

Kontrolloi të gjithë dokumentacionin e duhur dhe shfrytëzoi shumë të dhëna. Realizoi anketa me nxënësit, arsimtarët dhe prindërit. Nga të gjitha këto të dhënat të analizuar me përpikmëri e ka sjellë raportin vijues.

Për përgatitjen e Vetëevaluimit janë shfrytëzuar kahjet e Ligjit për Arsim Fillor, nga Vetëvlerësimi Integral i shkollës dhe rregullorja për Indikatorët e kualitetit të punës së shkollës përgatitur nga MASH-i dhe ISHA.

Qëllimi i Vetëevaluimit është që me analiza konkrete dhe shqyrtimi i punës së të gjitha fushave të punës së shkollës të fitohet pasqyrë për kualitetin e punës, përparimi dhe të arriturat e shkollës, anët e forta dhe të dobëta, për të cilët do të pasojnë propozim masat për kapërcimin e tyre.

Natyrisht se dobësit e vërejtura do të motivoj të gjithë pjesëmarësit në procesin edukativo-arsimor (të kyçur direkt apo indirekt) për ti vënë në zbatim të gjitha kapacitetet e veta duke i shfrytëzuar resurset ekzistuese për përmisimin e kushteve dhe standardeve në shkollë.

Në këte mënyrë do të kontribohet për realizimin kualitativ të procesit edukativo-arsimor. Vetëevaluimi i ndanë edhe prioritetet në lëmitë e veprimit për përmisimin dhe modernizimin e mësimi dhe aktivitet jashtëmësimore.

Qëllimi i të gjithë subjekteve në shkollë është që dobësit të jenë më të pakta, anët e forta të kenë ngritje graduale në kontinuitet.

LËMIT E VETË-EVALUIMIT

- 1. Planet dhe programet mësimore***
- 2. Të arriturat e nxënësve***
- 3. Mësimi dhe mësimdhënia***
- 4. Përkrahja e nxënësve***
- 5. Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë***
- 6. Resurset***
- 7. Udhëheqja, menaxhimi dhe krijimi i politikës***

LËMIA 1. PLANET DHE PROGRAMET MËSIMORE

Indikatorët

1.1 Realizimi i planeve dhe programeve mësimore

1.2 Planet dhe programet mësimore të hartuara nga ana e mësimeve

1.3 Aktivitetet e lira

Indikatorët: 1.1. Realizimi i planeve dhe programeve mësimore

Burimet e të dhënave:

Plan-programet e BZHA, MASH të miratuara 2020, 2021 dhe 2022

Plane globale, tematike dhe ditore të arsimtarëve,

Evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik,

Verbale nga aktivitetet dhe këshillat arsimore,

Pyetësorët anketues,

Programa vjetore e shkollës, raporte nga garat etj.

SHFK "Fan Noli" f.Trebosh-Pallaticë dhe Uzurmishtë gjatë punës së sajë përgjithësisht i realizon planet dhe programet mësimore të miratuara nga MASH-i. Nga kjo merren parasysh aftësitë individuale psikofizike të nxënësve dhe mundësia për kyçjen e prindërve në realizimin e të njejtave, varësisht nga lloji dhe shkalla e arsimimit të tyre në bazë të kërkesave për ndihmë, mendime, sugjerime dhe përfëshirjen e aktiviteteve të ndryshme të përshtatshme për profesionin e tyre.

Shkolla shfrytëzon të gjitha mundësitë që i ofron rrethi, për realizimin e suksesshëm të detyrave programore e cila kontribuon në ngritjen e nivelit kulturor dhe arsimor të popullatës.

Në fillim të vitit shkollor mësimdhënësit i njoftojnë nxënësit me përmbajtjet e planeve dhe programeve mësimore për vitin shkollor në vijim, kurse gjatë vitit shkollor në kornizat e programit të mësimit interaktiv përgatisin plane të integruara tematike. Me të njejtat njoftohen edhe prindërit e nxënësve.

Janë marë parasysh edhe propozim masat nga inspektorati shtetror i arsimit për sa i takon planeve dhe programeve mësimore, në drejtim të ndryshimit të tyre për planifikim më të mirë në të gjitha lëndët mësimore.

Në klasën e gjashtë nxënësit kanë mundësi të zgjedhin gjuhë të dytë të huaj kurse prej klasës së katërtë deri në të nëntën zgjedhin një lëndë nga të ofruarat si lëndë zgjedhore.

Programi i zgjeruar shkollor zbatohet sipas konceptit të ligjit për arsim fillor.

Indikatorët : 1.2 Kualiteti (cilësia) i(e) planeve dhe programeve mësimore

Burimet e të dhënave:

Planet globale, tematike
procesuale të arsimtarëve,
Përgatitjet ditore të arsimtarëve,
Pyetësorët anketues për arsimtar,
nxënës dhe prind,
Aktivet profesionale,
Procesverbal nga përgatitjet e
kontrolluara me shkrim.
Planet dhe programet mësimore
të miratuara nga MASH-i

Raporti përfundimtar i
inspektoratit shtetëror të arsimit
Anketimet e arsimtarëve për
zgjedhjen e lëndëve mësimore

- Planet dhe programet mësimore të lëndëve dhe klasave janë në përputhje me Ligjin për Arsim Fillor.
- Programi i zgjeruar shkollor zbatohet sipas konceptit të ligjit për arsim fillor.
- Shkolla nuk ka ndërmarë ndonjë iniciativë për ndryshimin dhe plotësimin e programeve mësimore për t'iu drejtuar institucioneve relevante si MASH-it, BZHA- as.
- Në orën e klasës kujdestari dhe psikolog-ja e shkollës ligjërojnë në tema që prekin moshën e nxënësve siç janë : varshmëria nga duhani, alkooli, droga, siguria dhe dhuna në shkollë etj.
- Në shkollë, integrimi i përgjithshëm i qëllimeve realizohet me sukses në të dy ciklet.
- Lëndët zgjedhore sipas plan-programeve të BZHA-së, zgjidhen nga ana e prindërve të nxënësve me anë të anketimit në mbarim të vitit shkollor.
- Shkolla nuk ua imponon nxënësve deklarin për përcaktimin e zgjedhjes së lëndës zgjedhore.
- Shkolla në mënyrë permanente bën anketim me prindërit e nxënësve për zgjedhjen e lëndës zgjedhore nga kl. IV-IX, duke u bazuar në programet mësimore të shpallura nga BZHA.

Në orën e klasës kujdestari dhe psikolog-ja e shkollës ligjërojnë në tema që prekin moshën e nxënësve siç janë : varshmëria nga duhani, alkooli, droga, siguria dhe dhuna në shkollë etj.

Mësimi i integruar jep mundësi për angazhim komplet të nxënësve për zgjedhjen e problemeve dhe detyrave, duke marrë ide të reja dhe duke punuar me shembuj konkret, situata dhe ngjarje.

Gjatë realizimit të planeve dhe programeve mësimore ekziston mundësi e barabartë për pjesëmarrjen e nxënësve të ndryshëm dhe përkatësisë gjinore në udhëheqje, bashkëpunim, marrëveshjen, vetbesimin dhe zgjedhjen e konflikteve.

Në planin e programit për punën e orëve mësimore janë të planifikuara përmbajtja e fushës të procesit shëndetësor që mundëson marrjen e informatave, njohuri për shëndetin dhe përparimin e tij të nxënësve për mënyrë jetese të shëndetëshme.

Në bashkëpunim me punktin shëndetsorë , Organizatën e Kryqit të Kuq Komunal dhe Ministrisë së Punëve të mbrendshme –Tetovë, janë organizuar ligjërata nga fushat e shëndetësisë (droga, alkooli, duhanin si dhe mbrojtja nga Virusi HIV,dhe Pandemia Covid-19, etj.

Indikatorët : 1.3 Aktivitete e lira (jashtëmësimore)

Burimet e të dhënave:

Programa vjetore e shkollës, evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik, pyetësorët anketues për arsimtar, nxënës dhe prind, mirënjohjet dhe lëvdatat.

- Shkolla jonë planifikon dhe realizon aktivitete jashtëmësimore sipas mundësisë së nxënësve dhe kushteve që ekzistojnë në shkollë.
- Numër i madh i nxënësve janë të kyçur në realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore,
- Nxënësit e shkollave periferike gjithashtu përfshihen në aktivitete jashtëmësimore,
- Nxënësit me vetë dëshirë inkuadrohen në aktivitetet jashtëmësimore,
- Arsimitarët i motivojnë nxënësit të marrin pjesë në aktivitetet jashtëmësimore me lëvdata dhe mirënjohje.
- Arsimitarët në kontinuitet realizojnë aktivitete të ndryshme jashta mësimore në disa lëndë përkatëse.
- Garat sportive, krosi pranveror si dhe vizitat që iu bëhen institucioneve të ndryshme (Shtëpia e Shëndetit – Tetovë, Galeria e Arteve, Komuna e Zhelinës, Univerziteti i Tetovës, Posta e Tetovës, Hidrocentrali në Matkë etj) janë aktivitete më atraktive për nxënësit.

Në garat poetike që organizohen nga Institucioni Nacional Biblioteka "Koço Racin" – Tetovë nxënësja jonë ka zënë vendin e parë. Poashtu edhe në gjuhën Maqedone që organizohet nga Posta e Maqedonisë nxënësja jonë ka zënë vendin e parë.

Arsimitarët i motivojnë nxënësit të marrin pjesë në aktivitetet jashtëmësimore, kjo tregon edhe faktin ku kemi 6 vajza që kanë nxjerë botimet e veta me poezi të përkrahur nga Klubi i shkrimtarëve Tetovë.

Metodat e shfrytëzuara: Mbledhja e të dhënave (pyetësorë, anketime, vëzhgime)

Metoda dhe teknika tjera të shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave

Subjekt të kyçur në mbledhjen e informacioneve vijuese

Informacionet e mbledhura

Anketa me shërbimin profesional dhe mësimeve	Ekipi për mbledhjen e të dhënave	<ul style="list-style-type: none"> - Nga ana e shërbimit pedagogjik të shkollës, mësimeve u ofrohet ndihmë konsultative gjatë përgatitjes së planeve dhe programeve. - 65% e mësimeve vet I hartojnë planet dhe programet mësimore (planifikimet), ndërsa 35 % e tyre këtë aktivitet e bëjnë përmes aktiveve profesionale. - Që të jenë më kualitative planifikimet e mësimeve u nevojiten trajnime permanente nga persona profesional të caktuar nga BZHA dhe MASH. 																
Anketa me nxënës	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit	<ul style="list-style-type: none"> - Nga gjithsej 100 nxënës të anketuar sumaret rezultojn se 75% e tyre nuk mendojnë se janë të mbingarkuar me lëndë dhe orë mësimore, ndërsa 25% e tyre mendojnë se janë të mbingarkuar. <table border="1" data-bbox="725 612 2192 751"> <thead> <tr> <th></th> <th>M</th> <th>F</th> <th>GJ</th> <th>PO</th> <th>%</th> <th>JO</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>nxënësit</td> <td>50</td> <td>50</td> <td>100</td> <td>30</td> <td>25</td> <td>70</td> <td>75</td> </tr> </tbody> </table>		M	F	GJ	PO	%	JO	%	nxënësit	50	50	100	30	25	70	75
	M	F	GJ	PO	%	JO	%											
nxënësit	50	50	100	30	25	70	75											
Bisedë me grup të nxënësve	Informacionet janë mbledhur nga shërbimi profesional i shkollës	Nga informacionet e mbledhura nga shërbimi profesional në bisedë me nxënësit konstatojmë se 80% e tyre nuk kanë mbingarkesë në orë dhe lëndë mësimore, dhe gjithashtu përgjigja ishte edhe për detyrat e shtëpisë ku 80% konstatojmë se nuk janë të mbingarkuar me detyra shtëpie, dhe 20% janë të ngarkuar me orët mësimore dhe 20% e tyre të ngarkuar shumë me detyra shtëpie.																
Anketa me prind	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga prindët	Mësimeve mendojnë se prindët mund të ndikojnë në lidhje me mënyrën e realizimit të planeve mësimore. Poashtu edhe prindët mendojnë se arsimtarët duhet të jenë më të përgatitur për zhvillimin e programeve mësimore. Në anketën të realizuar me prind (100 të anketuar) në pyetjen : A jeni të kënaqur me punën e arsimtarëve në shkollë konstatojmë se 79% e tyre janë të kënaqur , dhe 21% nuk janë të kënaqur.																

Rezultatet e përmbledhura

Anët e forta

- Planet dhe programet mësimore, në përgjithësi realizohen si në aspektin kuantitativ, poashtu (deri diku) edhe në aspektin kualitativ.
- Mësimdhënësit për çdo vit shkollor përgatisin plane dhe programe, planifikime vjetore (globale), mujore (tematike), dhe ditore.
- Shërbimi profesional në mënyrë permanente bën përcjelljen e kualitetit të planifikimit të punës së mësimdhënësve,
- Shërbimi profesional mësimdhënësve u ofron ndihmë konsultative gjatë hartimit të planifikimeve.
- Ekziston bashkëpunimi në nivel në mes - bashkëpunëtorëve profesional dhe arsimtarëve,
- Mësimdhënësit u ofrojnë ndihmë nxënësve për arritjen e rezultateve sa më të mira.

Anët e dobëta

- Mungesa e kabineteve lëndore, për realizimin në tërësi të planeve dhe programeve mësimore (si në aspektin kualitativ, ashtu edhe në aspektin kuantitativ).
- Trajnimi i pamjaftueshëm i mësimdhënësve për hartim më efikas të planeve dhe programeve mësimore, dhe përshtatja më adekuate sipas kushteve ekzistuese
- Mungesa e mjeteve moderne për mësimdhënie dhe ndihmë për zbatimin e suksesshem te programeve mësimore ,
- Mungesa e mjeteve didaktike materializuese lëndore,
- Mospërfshirja e prindërve në planifikimin dhe realizimin e planeve dhe programeve mësimore.
- Mungesa e mjeteve stimuluese dhe shpërblimeve për mësimdhënësit dhe nxënësit e dalluar të cilat arrijn rrezultate të shkëlqyeshme në shkollë.

Analiza e rezultateve

Planet dhe programet mësimore janë në pajtim me programet e MASH-it dhe të njëjtat realizohen në vëllimin e paracaktuar. Ka disa mangësi në përmbajtjet mësimore dhe gjatë viteve të fundit mungesa e teksteve në disa lëndë të caktuara.

Vazhdimisht furnizohemi me të njëjtat tekste shkollore të adaptuara nga Kembrixhi. Prindërit dhe nxënësit nuk njoftohen me përmbajtjet dhe lëndët e caktuara mësimore, në përjashtim të prindërve që janë të kyçur në kryesit apo Këshillin e shkollës.

Edhe pse në shkollë kemi nxënës me nevoja të veçanta, ato përsëri përfshihen në kuadër të mësimin të rregullt. Edhe pse nuk ka mjete të mjaftueshme dhe kushte adekuate për mbarëvajtjen e procesit mësimor me këto nxënës, përsëri arsimtarët posedojn planin individual enkas për këto nxënës (2 nxënës), dhe njëkohësisht i përmbahen deri diku planit inkluziv.

Gjithashtu shumica e arsimtarëve posedojn çertifikatën për arsimin inkluziv të marrë nga BZHA në mënyrë online.

Prindërit më tepër ankohen se nxënësit kanë ngarkesë në shumë lëndë dhe orë mësimore, dhe se materiali i tanishëm është tepër ndërlikuar edhe për ata, dhe nuk mund tu ndihmojn fëmijëve të tyre në këtë aspect.

Si lëndë zgjedhore nxënësit mësojn Krijimtari dhe Origami varësisht cilën lëndë e zgjedhin (kl.IV dhe V), Njohje me religjionit (kl.VI), Arsimi Teknik (kl.VII), Projekte nga Informatika (kl.VIII), dhe Projekte nga Arsimi figurativ dhe Projekte nga arsimi muzikorë (kl. IX).

Nxënësit me nevoja të veçanta nuk përfshihen në aktivitetet e lira jashta mësimore për arsye se mungojn mjete materiale dhe për shkak të kushteve hapësinore.

PRIORITETET

Sferat prioritare mund të përfshihen në Planin zhvillimor të shkollës

- Të sigurohen disa kabinete lëndore me qëllim të realizimit më efikas të planeve dhe programeve mësimore,
- Të mbahen trajnime adekuate nga BZHA për mësimdhënësit në planifikimin e punës mësimore,
- Të sigurohen kushte të mjaftueshme hapësinore dhe mjete materiale për mbarëvajtjen e procesit mësimor për përfshirjen e planit inkluziv.
- Vendosja e tabelave interaktive, që në mënyrë më efektive të zhvillohet mësimi

LËMIA 2. TË ARRITURAT E NXËNËSVE

Indikatorët

2.1 Të arriturat e nxënësve

2.2 Mbajtja/shpërndarja e nxënësve

2.3 Përsëritja e nxënësve

Indikatorët: 2.1 Të arriturat e nxënësve

Burimet e të dhënave:

Raportet vjetore për suksesin e nxënësve,
raportet e kujdestarëve të klasave,
raportet e arsimtarëve lëndor, ditari i klasës.
Procesverbale nga mbajtja e mbledhjeve të aktiveve profesionale
Raporti vjetor për mësimin

- Shkolla disponon me të dhëna të suksesit të përgjithshëm dhe sipas lëndëve të nxënësve për vitet e fundit por edhe në periudhën 2020-2022.
- Gjatë regjistrimit të nxënësve në klasën e parë identifikohen nxënësit me nevoja të veçanta dhe kërkohet mendimi nga mjekët specialist.
- Në bazë të analizave të suksesit të nxënësve në çdo tre mujor, gjysëmvetor dhe fund vitit shkollor sukses më të lartë nxënësit arrijnë në lëndët mësimore të shkathtësive si arsimin fizik dhe shëndetësor, arsimin teknik dhe

klasorë dhe lëndorë të vitit shkollor 2020/2021
 Raporti i vjetorit për mësimin klasorë dhe lëndorë të vitit shkollor 2021/2022
 Procesverbalet e mbajtjes së këshillave të klasave
 Plani dhe programi për realizimin e mësimin shtues
 Diploma dhe çmimet e marra nga garat republikane dhe regjionale
 Analiza e suksesit të nxënësve gjatë kalimit prej klasës-V-të-VI-të.

- arsimin figurativ, kurse sukses më të ulët në lëndët matematikë, kimi dhe histori.
- Gjithashtu vlen të theksohet se sipas krahasimit të analizave statistikore del se në gjysëvjetorin e parë suksesi është më i ulët në krahasim me fundvitin shkollor,
 - Edhe përcjellja nga cikli në cikël dallon tek nxënësit, ku vërehet ulje e suksesit.
 - Pra sipas vlerësimit nxënësit e klasës së V janë me sukses më të lartë (me notë mesatare), dhe gjithashtu këtë e arrijnë nxënësit e gjinisë femërore.
 - Në çdo tremujor nga ana e kujdestarëve të klasave bëhet raporti i suksesit dhe sjelljes dhe diciplinës së nxënësve, ku përpunohen nga ana e shërbimit pedagogjik dhe në çdo mbledhje të këshillit të arsimtarëve ata publikohen.

Viti 2020-2021 dhe 2021-2022.

Klasat	IV (2020-21)	V (2020-21)	VI – IX (2020-21)	IV (2021-22)	V (2021-22)	VI – IX (2021-22)
Gjysëvjetori i parë	4.19	4.1	3.61	3.95	4.05	3.48
Fundi i vitit	4.06	4.25	3.84	3.87	4.06	3.9

Nga analiza del për disa vite radhazi sukses më të lartë shënohet në ciklin klasor.

Në gjysëvjetor ka 10 % e nxënësve me nota të dobëta, ndërsa në fund të vitit shkollor të gjithë nxënësit kalojnë pastër pa asnjë notë të dobët.

Poashtu 100% të nxënësve e mbarojnë klasën e IX, dhe 100% e tyre e vazhdojnë shkollimin e mesëm.

Indikatorët: 2.2 Mbajtja / shpërndarja e nxënësve

Burimet e të dhënave:

Ditari i klasës,

Libri amë,

- Listën për regjistrim në klasën e parë rregullisht e marrim prej Komunës dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit. Gjithashtu bashkëpunojmë me Shtëpinë e shëndetit prej të cilëve marrim listën e fëmijëve që vaksinohen sipas vitit të lindjes dhe që duhen të regjistrohen në klasën e parë.

Fletshpërngulje,	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Është trend i kohës shpërngulja masive në vendet e Europës për shkaqe ekonomike sociale dhe si rrjedhojë e kësaj vjen deri te zvogëlimi i numrit të nxënësve nëpër klasa. ➤ Gjatë kalimit të nxënësve nga një shkollë në tjetrën dhe fletë shpërngulje për në shkolla në shtete të tjera, sekretari i plotëson fletëshpërnguljen me nënshkrim të kujdestarit të klasës me të dhënat për nxënësin dhe suksesin e tij. ➤ Nëse regjistrohen në shkollë të shtetit tonë na rrikthehet dëshmia se janë rregjistruar në shkolla përkatëse dhe se e vijojnë mësimin në ato shkolla, ndërsa nëse shkojnë jashtë shtetit shumë rallë marrim dëshmi se e vazhdojnë shkollimin atje përshkak të mos kujdesit të prindërve. ➤ Rregullisht bëhet evidentimi i nxënësve që marrin fletëshpërngulje.
------------------	--

Indikatorët: 2.3 Përsëritja e nxënësve

Burimet e të dhënave: Raportet vjetore për suksesin e nxënësve, raportet e kujdestarëve të klasave, raportet e arsimtarëve lëndor, Statuti i shkollës, Procesverbalet nga mbledhjet e Këshillit të shkollës.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Nxënës të panotuar për arsye të panjohura nuk ka pasur brenda këtyre viteve. ➤ Në vitet shkollore 2020/2021 dhe 2021/2022, nxënës që e përsëritin vitin gjithashtu nuk ka pasur, për shkak të periudhës pas pandemis, ku nxënësit përjetuan periudha shumë të vështira. ➤ Edhe pse statuti i shkollës parasheh të drejtat dhe ankesat e nxënësve që përsërisin vitin, por në praktikë kjo gjendje nuk është konstatuar për shkak se nuk kemi pasur nxënës të tillë.
--	---

Metodat e shfrytëzuara: Mbledhja e të dhënave (pyetsorë, anketime, vëzhgime)

Metoda dhe teknikat e shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave	Subjekte të kyçur në mbledhjen e informacioneve	Informacionet e mbledhura
---	---	---------------------------

Biseda me mësime	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga mësuesit	Në bazë të anketave me 40 mësues (26 F dhe 14 M), konstatohet se 70% e tyre mendojnë se nxënësit nuk tregojnë rezultate të suksesshme, ndërsa 30% mendojnë se arrijnë rezultate të mira. Kjo është si pasojë e mos interesimit të prindërve për fëmijët e tyre në shkollë.																
Anketa me nxënës	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit	Nga gjithsej 100 nxënës të anketuar (50 M dhe 50 F), nga klasat VI-IX, 65 prej tyre apo 65% e tyre janë të kënaqur me rezultatet e arritura në shkollë, kurse 35 prej tyre apo 35% nuk janë të kënaqur. <table border="1" data-bbox="521 496 2150 624"> <thead> <tr> <th></th> <th>M</th> <th>F</th> <th>Gjithësej</th> <th>PO</th> <th>%</th> <th>JO</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Nxënësit</td> <td>50</td> <td>50</td> <td>100</td> <td>65</td> <td>65</td> <td>35</td> <td>35</td> </tr> </tbody> </table>		M	F	Gjithësej	PO	%	JO	%	Nxënësit	50	50	100	65	65	35	35
	M	F	Gjithësej	PO	%	JO	%											
Nxënësit	50	50	100	65	65	35	35											
Anketa për prind	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga prindërit	Edhe përkundër faktit se nxënësit janë të mbi ngarkuar me orët mësimore, dhe nuk mund t'ia arrijnë qëllimit për sukses dhe rezultate më të mira, shumica e prindërve janë të kënaqur me suksesin e fëmijëve të tyre, por në pyetjen se fëmijët e tyre a janë të mbingarkuar më orët mësimore konstatohet se 77 % e prindërve deklarojnë se nuk janë të mbingarkuar me orë mësimore, përkundër 23% se janë të ngarkuar me orë mësimore. <table border="1" data-bbox="521 916 1525 1050"> <thead> <tr> <th>Gjithësej</th> <th>100</th> <th>PO</th> <th>JO</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prindët</td> <td>100</td> <td>77%</td> <td>23%</td> </tr> </tbody> </table>	Gjithësej	100	PO	JO	Prindët	100	77%	23%								
Gjithësej	100	PO	JO															
Prindët	100	77%	23%															
Takime individuale me prind, nxënës dhe mësues		Mësuesit mendojnë se prindërit mund të ndikojnë në lidhje me mënyrën e realizimit të planeve dhe programeve mësimore. Poashtu disa arsimtarë (mësues) që janë si përfaqësues të Këshillit të Prindërve të Shkollës, vlerësojnë se mësuesit që nuk kanë ndjekur trajnime profesionale për aftësi të planifikimeve ditore dhe mujore paraqet ngarkesë për ata dhe gjithashtu edhe mbingarkesë për nxënësit. Rreth 50% e prindërve mendojnë se fëmijët e tyre mund të arrijnë rezultate më të mira nëse bashkëpunimi i tyre me shkollën																
Bisedë me drejtorin dhe																		

<p>pedagogen e shkollës</p> <p>Azhurimi i raporteve nga ana e ISHA dhe BZHA-së – Tetovë</p>	<p>Ekipi për mbledhjen e të dhënave</p>	<p>është në nivelin e duhur, por tek ne kjo has në kundërshtim për shkak se prindët nuk janë të interesuar aq sa duhet për fëmijët e tyre dhe neglizhenca e tyre ndikon tepër në suksesin e tyre.</p> <p>Poashtu vlen të theksohet se shumica e prindërve ankohen për mos pajisjen e fëmijëve të tyre me libra shkollor të reja, dhe në kohë, gjë që ndikon shumë edhe në suksesin e tyre, dhe se 100% e tyre theksojn se janë të gatshëm që fëmijëve të tyre t’ua blejn librat vetëm e vetëm që nxënësit mos të ngelin pa tekste mësimore apo me tekste shumë të vjetëruara.</p> <p>Gjatë këtij viti shkollor vlen të theksohet se gjatë mbajtjes së Këshillimit të prindërve të nxënësve (me mungesa të shumta dhe sjellje asociale) nga ana e psikologes së shkollës prej 23 prindërve të ftuarë, në këshillim kanë qenë prezent 35% e prindërve, gjë që tregon se prindët nuk angazhohen për fëmijët e tyre dhe interesimi i tyre është aq i ulët dhe kjo ndikon negativisht në ngritjen e suksesit të fëmijëve të tyre.</p> <p>Poashtu vlen të theksohet se Drejtori, Shërbimi profesional dhe Inspektorati për arsim në bazë të hospitimeve pedagogjike, konstatojm se rreth 75% e këtyre orëve rezultojn të suksesshme ndërsa 25% tyre nuk realizohen sipas metodave të reja bashkëkohore.</p>
---	---	---

Rezultatet e përmbledhura

Anët e forta

- Të gjithë nxënësit e mbarojnë arsimin fillor – nuk kemi nxënës që e përsëritin vitin këto vitet e fundit;
- Në shkollë ekzistojnë dokumente për përcjellje sistematike në kohë dhe analizë të gjendjes së suksesit dhe arritjeve të nxënësve në periudha klasifikimi, në klasa, lëndë mësimore dhe gjatë kalimit prej një viti në vit tjetër shkollor;
- -Suksesi mesatar i nxënësve në nivel të shkollës në tre vitet e fundit është: për vitin shkollor **2019/20** mesatarja në fund të vitit ka qenë **3.89 %**, në fund të vitit shkollor **2020/21** ishte **3.95 %** dhe në fund të vitit shkollor **2021/22** ka qenë **3.84 %**.
- Nxënësit dhe prindërit në kohë dhe rregullisht informohen për arritjet dhe përparimin e nxënësve nga ana e arsimtarëve;
- Këto vite edhe pse të vështira kemi patur promovim të botimit të tre librave nga ana e nxënësve të kësaj shkolle, gjë që tregon se procesi mësimor shënon ngritje.
- Kemi nxënës fitues nëpër gara të ndryshme, ku kemi zënë vendin e parë, të dytë dhe të tretë dhe ku jemi shpërblyer me lëvdata dhe mirënjohje.
- Një numër i caktuar i mësimdhënësve mbështesin nxënësit (e talentuar, me vështirësi në mësim dhe me nevoja të veçanta) duke realizuar orë nga mësimi shtesë dhe plotësues në disa lëmi të caktuara.
- Mësimdhënësit u japin ndihmën e tyre nxënësve në arritjen e rezultateve sa më të mira.
- Shkolla jonë sjell masa pedagogjike ndaj nxënësve që mungojnë si: (qortim, vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim, ulje të sjelljes dhe transferim në shkollë tjetër).
- Punimet e nxënësve janë të ekspozuara nëpër klasa dhe në kënde të shkollës.

Anët e dobëta

- Suksesi i nxënësve është pak i dobët për shkak se është fillimi i parë i vitit shkollor pas pandemisë;
- Suksesi i nxënësve të ciklit të lartë është më i dobët në krahasim me ciklin e ulët ;
- Pranimi me vështirësi i disa mësimdhënësve të implementojn metodat e reja të mësimdhënies.
- Një numër i caktuar i mësimdhënësve nuk aplikojn metoda bashkëkohore për notimin dhe vlerësimin e të arriturave të nxënësve
- Përfshirja e pamjaftueshme e prindërve dhe nxënësve në vlerësimin e të arriturave të nxënësve
- Mospërfshirja e mësimdhënësve dhe sidomos mosangazhimi i prindërve me nxënësit me nevoja të veçanta sjell vështirësi në realizimin e procesit mësimor.
- Mungesa e teksteve shkollore në kohë,
- Kemi çdo vit migrim të nxënësve jasht shtetit si dhe brenda shtetit në raste të ralla por evidente.

Analiza e rezultateve

Arritjet e nxënësve

Rezultatet dhe të arriturat e nxënësve synohen më tepër përmes sigurimit të pajisjeve materiale mësimore dhe përmisimit të infrastrukturës së shkollës. Kjo poashtu arrihet edhe nëpërmjet kabineteve lëndore përkatëse, sallës së sportit, pajisjeve teknologjike bashkëkohore, mjeteve didaktike, pajisja në kohë të librave shkollorë, gjë që kohëve të fundit shumë rëndë realizohet etj.

Një numër i konsiderueshëm i prindërve nuk janë të kënaqur me suksesin e nxënësve, por një pjesë e tyre edhe janë të kënaqur me të arriturat e tyre, kjo shihet edhe me të arriturat në shkollimin e mesëm ku nxënësit kanë rezultate relativisht të mira apo mesatare.

Orët mësimore realizohen në përcjellje dhe monitorim të vazhdueshëm.

PRIORITETET – Aktivitetet e ardhshme

- Sigurim të kushteve për mirëvajtjen e procesit edukativo-arsimor ,
- Sigurimi i kabineteve lëndore me mjete teknologjike bashkëkohore,
- Trajnime permanente me mësimdhënësit për nxënësit me nevoja të posaçme (ku gjithsej kemi dy nxënës.),
- Trajnim me mësimdhënësit për aplikimin e metodologjisë bashkëkohore për vlerësimin dhe notimin e nxënësve,
- Rregullore për shpërblimin e nxënësve të shkëlqyeshëm – superior, dhe rregullore për ndëshkimin e nxënësve të dobët,
- Përcjellja e të arriturave të nxënësve nga një cikël në një cikël tjetër.

LËMIA 3. MËSIMI DHE MËSIMDHËNIA

- **Indikatorët**
- **3.1 Planifikimet e mësimdhënësve**
- **3.2 Procesi i mësimdhënies**
- **3.3 Përvoja e nxënësve nga mësimi**
- **3.4 Plotësimi i nevojave arsimore të nxënësve**
- **3.5 Notimi si pjesë e mësimdhënies**
- **3.6 Raportim mbi progresin e nxënësve**

Indikator: 3.1 Planifikimet e mësimdhënësve

Burimet e të dhënave:

Programi vjetor i punës së shkollës

Planet dhe programet e miratuara nga MASH-it, dhe BZHA,

Planet dhe programet e përgatitura nga mësimdhënësit

Çdo vit shkollor, ekipi punues i shkollës i udhëhequr nga Drejtori i shkollës dhe me ndihmën e shërbimit pedagogjik, përgatit Program vjetor për punën e shkollës.

Në realizimin e planeve dhe programeve mësimore (planifikimeve), mësimdhënësit përgatisin vazhdimisht plane globale, tematike (periodike) dhe ditore që i sjellin në fillim të vitit shkollor (gjatë shtatorit), por nëse nuk ka ndryshim të planprogramit bëhet përcjellja e planeve nga një mësimdhënës në tjetrin me ndërhyrje, si dhe e njëjta bëhet gjatë planifikimit të planeve ditore.

Përveç këtyre planeve, një numër i madh i konsiderueshëm i arsimtarëve bëjnë edhe planifikime dhe konspekte ditore, por shërbimi vazhdimisht kërkon që kjo të bëhet nga të gjithë mësimdhënësit dhe jo pjesërisht nga pjesa e tyre.

Për këtë shërbimi ka sistem të organizuar për përcjelljen e vazhdueshme të planifikimeve të arsimtarëve.

<p>Raporte vjetore për punën e shkollës ,</p> <p>Seminaret e mbajtura</p>	<p>Aktivitetet profesionale e sidomos e arsimtarëve me përvojë janë në nivelin e duhur, (përmes këshillimeve, sugjerimeve dhe puntorive).</p> <p>Realizimi i seminareve të organizuara nga ana e MASH-it, dhe BZHA-së, shkolla jep ndihmë në mësimdhënësve në ngritjen dhe efikasitetin e planifikimeve dhe realizimin të mirëfilltë të punës mësimore, por është e nevojshme trajnimi periodik i mbajtjes së seminareve.</p> <p>Kohëve të fundit kemi ndjekur seminare të ndryshme për realizimin e mësimit online ku e kanë ndjekur të gjithë arsimtarët dhe trajnime profesionale për mësimdhënësit në planifikimin e orëve, planifikimin e konspekteve ditore, planin operativ dhe në mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p>Të gjithë arsimtarët kanë incizuar orë mësimore që i kemi dërguar në Eduino.</p> <p>Kemi pasur edhe arsimtarë që kanë realizuar orë edhe drejtëpërdrejtë në RTVM2 në shqip.</p> <p>Të gjithë arsimtarët kanë portfoliot e tyre për zhvillimin profesional të procesit edukativo arsimor.</p>
---	--

Indikatori: 3.2 Procesi i mësimdhënies

Burimet e të dhënave:

Dosjet e arsimtarëve,
programi i mentorit,
programa për zhvillimin profesional të arsimtarëve,
protokolli për vlerësimin e orëve mësimore
proceverbale nga përgatitjet ditore të arsimtarëve,
procesverbale nga përcjellja e realizimit të aktiviteteve të lira jashta mësimore.

Në shkollën tonë ka dallime në përdorimin e formave të ndryshme të mësimdhënies, si puna në grupe, individuale, aktivitetet praktike, shfrytëzimi i resurseve dhe mjeteve dhe materiale didaktike të ndryshme, por ajo çka vërehet më së shumti është se format klasike përdoren më së shumti nga të gjithë mësimdhënësit.

Në kohën e fundit në format mësimore përdoret edhe teknologjia e informimit (TIK-ut). Edhe pse shkolla posedon kabinete të teknologjisë, por ka ngecje në realizimin e tërësishëm të planitprogramit me tik, për shkaqe subjektive, për shkaqe të mjeteve teknologjike etj, dhe kabinetet më shumë përdoren për lëndën e Informatikës.

Mësimdhënësit përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive si psh parashtrim pyetjesh, diskutim mes nxënësve, mësim individual, zhvillim nga ana e arsimtarit dhe forma frontale, kurse nga nxënësit ende kërkohet mësim mekanik, dhe shumë i kushtohet rëndësi të mësuarit logjik. Prandaj për këtë kërkohet të ketë një trajnim i veçantë dhe imediat i kuadrit arsimor.

Nga hospitimet e realizuara, dhe nga vëzhgimet hulumtuese përcjellja e aktiviteteve të lira, por edhe nga të dhënat e sublimuara nga hulumtimet e nxënësve dhe mësimdhënësve ka një përshtypje se gjinia femërore në numër të konsiderueshëm angazhohen më tepër në aktivitete të ndryshme mësimore dhe jashta mësimore me arsyetim se gjinia femërore janë më tepër të interesuar për procesin edukativo arsimor

Indikatori: 3.3 Përvoja e nxënësve në mësim

Proceverbale nga analiza krahasuese e suksesit në të

Në shkollën tonë dallohen nxënësit e shkëlqyeshëm dhe nxënësit me sjellje të mirë, duke u dhuruar lëvdata, mirënjohje dhe libra.

Në mungesë të mjeteve financiare shkolla nuk ka mundësi ti shpërblej nxënësit dhe punëtorët e dalluar arsimor, me ndonjë stimulim (mjete financiare), apo pushim disa ditësh në ndonjë vend turistik.

<p>arriturat e nxënësve</p>	<p>Në hapësirat frekuentuese të objektit shkollor nxënësit dhe disa mësime të cilat janë udhëheqës të sesioneve të caktuara të disa aktiviteteve të lira, nxënësit bëjnë ekspozimin e punimeve të ndryshme dhe poezive dhe prozave të ndryshme, (psh kemi këndin e fizikës , të artit figurativ ku nxënësit ekspozojn vizatimet më të bukura , klubin letrar me emrin “ Jusuf Gërvalla”, ku nxënësit ekspozojn poezit e botuara nga vetë nxënësit, hartimet më të bukura dhe shkrimet e tjera me vlera artistike. Poashtu kemi krijuar edhe faqjen në rrjetet sociale në facebook, ku i publikojm vetëm poezitë dhe njoftimet nga shkolla. Në këtë vit shkollor 2019/2020 kemi patur promovimin e dy veprave nga dy nxënës të shkëlqyera të klasës së shtatë në fshatin Trebosh. Këto vepra u shpërndan të gjithë arsimtarëve dhe pjesmarrësve në këtë eveniment. Gjatë vitit 2020/2021 kishim edhe promovimin e tre veprave të tjera të nxënësve tona të klasave të IX. Poashtu shkolla në mungesë të mjeteve financiare nuk ka mundësi ta botoj gazetën e shkollës, gjë që është realizuar disa vite më herët, edhe pse për këtë ekzistojn kapacitete profesionale. Në lëndën e shkencave natyrore poshtau është bërë vizitë në Institutin e Shëndetit në Tetovë ku është bë analiza e ujit të pijshëm për të dy shkollat Trebosh – Pallaticë.</p>
	<p>Indikator: 3.4 Plotësimi i nevojave arsimore të nxënësve</p>
<p>Proceverbale nga Këshilli i prindërve dhe takimet me prind.</p>	<p>Një numër i madh i prindërve janë të interesuar për rezultate dhe suksese më të mira në mësim. Mësime të cilat i identifikojn nevojat arsimore të nxënësve nëpërmjet bashkëbisedimeve, anketave ushtrimeve me shkrim dhe me gojë, përmes bashkëpunimit me prind dhe ndërmjet shërbimit pedagogjik të shkollës. Gjithashtu mësime të cilat u jepet ndihmë profesionale nga ana shërbimit profesional të shkollës për plotësimin dhe përbushjen e nevojave individuale arsimore. Edhe arsimtarët kujdesen në mënyrë të veçantë për nxënësit e talentuar, duke i ndihmuar në realizimin e qëllimeve të tyre (si botimi i veprave, ndjekja e kurseve të ndryshme, pjesmarrja nëpër gara), etj. Psh arsimtari i gjuhës shqipe me ndihmën që i</p>

ofroi nxënëses Suela Rushiti që të marrë pjesë në garat republikane të shpallura nga Posta e Maqedonisë në bashkëpunim me Unionin për kujdesje në RMV me iniciativë të Unionit Postar Botëror me titull “**shkruaj letër heroit tim**”, ku nxënësja zuri vend dhe u shpërblye me mirënjohje nga ana e tyre.

Nxënësja Azra Alija zuri vendin e parë në garat poetike të organizuara nga Biblioteka e Tetovës.

Nxënësja Elsa Beqiri zuri vendin e parë dhe u shpërblye me mirënjohje në garat republikane të udhëhequra nga Posta e Maqedonisë, si dhe nxënësja Arlinda Ramadani zuri vendin e tretë.

Indikatori: 3.5 Notimi si pjesë e mësimdhënies

Për notimin dhe vlerësimin e përparimit të nxënësve praktikohen forma dhe metoda të ndryshme. Aplikohet notimi me shkrim nga (I-III), dhe numerik nga klasa IV-IX. Por tani duhet theksuar se në tremujorin e parë, në gjysëmvjetor dhe në tremujorin e tretë është bërë vlerësimi me shkrim nga klasa e I deri në klasën e VI.

Secili arsimtarë ka kriteriumin e vetë personal për vlerësimin e nxënësve, ka mësimdhënës me kriterium të fortë, por ka edhe të tillë me kriteriume mesatar dhe të lehtë.

Notimi formativ i nxënësve realizohet në mënyra të ndryshme, nëpërmjet instrumentit me shkrim, teste kontrolluse, kontrollim gojor, çek listave etj.

Për këtë qëllim arsimtarët shfrytëzojnë lista evidentuese, pyetësorë, teste, raporte dhe mbahet edhe dosje e nxënësve.

Indikatori : 3.6 Raportim mbi progresin e nxënësve

Për përparimin e nxënësve, nxënësit çdoherë marrin informacione gojore dhe me shkrim nga çdo mësimdhënës i lëndës përkatëse, por edhe nga udhëheqësi i paraleles në çdo orë klase.

Gjithashtu edhe prindërit e nxënësve marrin informata nga kujdestarët e klasave që organizojn mbledhje prindore (4 mbledhje brenda vitit shkollor), si dhe konsultime individuale. Gjithashtu vlerësimet prindëre u shkojnë rregullisht edhe nëpërmjet mesazheve elektronike nga ditari elektronik, dhe çdoherë arsimtarët kujdestarë bëjnë ndjekjen e dërgimit të këtyre mesazheve.

Përveç kësaj informacionet rregullisht jepen edhe në çdo tremujor , gjysëm vjetor dhe tremujor të tretë, me fleta vlerësuese dhe fundi i vitit shkollor me dëftesa të lëshuara nga ana e shkollës.

Metodat e shfrytëzuara: Mbledhja e të dhënave (pyetsorë, anketime, vëzhgime)

Metodat e shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave	Subjekte të kyçur në mbledhjen e informacioneve	Informacionet e mbledhura								
Anketa me nxënës	Ekipi për mbledhjen e informacioneve me nxënës	<p>Nga gjithësej 100 nxënës të anketuar (50 M dhe 50 F), në pyetjen: Sa jeni të kënaqur me përgatitjen arsimtarëve për orët mësimore, 85% deklarohen se janë të kënaqur, dhe 15 % nuk janë të kënaqur.</p> <table border="1" data-bbox="815 1161 1944 1235"> <thead> <tr> <th>Gjithësej</th> <th>100</th> <th>Të kënaqur</th> <th>Jo të kënaqur</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Nxënësit</td> <td>100</td> <td>85%</td> <td>15%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në pyetjen e rradhës Cila është lënda më e preferuar për ju? Nga 100 të anketuar (50 M dhe 50F), prej tyre 28% e preferojn gjuhën angleze dhe 21% arsimin fizik dhe shëndetësor. Poshtu sipas anketës dominon si lëndë e preferuar edhe gjuha shqipe me 13%. Kurse si lëndë jo e preferuar është matematika me 40% dhe gjuha frenge me 22%.</p>	Gjithësej	100	Të kënaqur	Jo të kënaqur	Nxënësit	100	85%	15%
Gjithësej	100	Të kënaqur	Jo të kënaqur							
Nxënësit	100	85%	15%							

Anketa me nxënës	Gjithësej	100	Të kënaqur	Jo të kënaqur
	Nxënësit	100	Gjuha angleze 28 %	Matematika 40 %
	Nxënësit	100	Arsimi fizik dhe shëndetësor 21 %	Gjuha Frenge 22 %
	Nxënësit	100	Gjuha shqipe 13%	
Anketa me prind	<p>Poashtu nxënësit janë të kënaqur me publikimin e punimeve të tyre në këndet e shkollës, si të gjuhës shqipe, artit figurativ, fizikës etj me punime, vizatime, pjesmarrja në gara sportive e shumë punime tjera.</p> <p>Kurse sa i përket anketës me prind në pyetjen se a jeni të kënaqur me punën të mësimit të nxënësve për orën mësimore deklarohen se 77% janë të kënaqur, kurse 23% deklarohen se nuk janë të kënaqur.</p> <p>Në pyetjen se a mund të ju ndihmoni fëmijëve tuaj në mësim, 94% deklarohen se mund të ju ndihmojnë, kurse pjesa tjetër rreth 6% nuk mund të ju ndihmojnë për shkak të angazhimeve të shumta që kanë ata, dhe për shkak se shumica e tyre punojn jashtë shtetit.</p> <p>Nga 100 prind të anketuar 76% e tyre mendojnë se fëmijët e tyre notohen në mënyrë të drejtë dhe objektive, kurse 26% mendojnë se notimi bëhet nuk bëhet në mënyrë objektive .</p> <p>Në pyetjen e rradhës se a jeni të kënaqur me informimin e suksesit dhe të arriturat e nxënësve, 84% deklarohen se janë të kënaqur me mënyrë e informimit të suksesit, ndërsa 16% nuk janë të kënaqur.</p> <p>Poashtu 80% e prindërve deklarojn se fëmijët e tyre apo nxënësit nuk e kanë të organizuar kohën e lirë, ndërsa 20 % e tyre konstatojnë se e kanë të organizuar kohën e lirë.</p>			

Rezultatet e përmbledhura

Anët e forta

- Mësimdhënësit për çdo vit përgatisin plane globale, mujore dhe tematike si dhe planifikime ditore për orën mësimore.
- Orët mësimore realizohen në përpikmëri nga vëllimi i caktuar nga MASH, BZHA, si dhe janë të adaptuara edhe Programet e Kembrixhit.
- Orët realizohen në mënyra dhe forma të ndryshme, si individuale, në grupe, me TIK, me orë të hapura etj.
- Për vlerësimin e njohurive dhe diturive të nxënësve përdoren metoda të ndryshme ku shfrytësohen testime interne, hartime dhe pyetje gojore individuale dhe grupore.
- Shërbimi pedagogjik profesional së bashku me drejtorin e shkollës në mënyrë permanent bëjnë ndjekjen dhe përcjelljen e mësimdhënësve në orët mësimore ku ato vizitohen së paku dy herë në një gjysëm vjetor, që të bëhet përmisimi i procesit mësimor.
- Shkolla rregullisht bën informimin e prindërve për rezultatet e fëmijëve të tyre në mësim, qoftë nëpërmjet mbledhjeve, porosive nga ditari elektronik dhe fletë vlerësimeve në çdo tremujor.

Anët e dobëta

- Njohuria jo e mjaftueshme e mësimdhënësve për përgatitje më kualitative të planeve dhe programeve mësimore për realizimin sa më efikas të mësimin.
- Trajnimi i arsimtarëve për punë me nxënës me nevoja të veçanta.
- Mos stimulimi i mësimdhënësve dhe nxënësve të dalluar,
- Angazhimi jo sa duhet i prindërve për ngritjen dhe suksesin e nxënësve.
- Mungesa e projektorëve për realizimin e plot të TIK-ut.
- Mungesë e doracakëve dhe literaturë për fëmijët me nevoja të veçanta.

Analiza e rezultateve

Nga analiza e rezultateve rezulton se mësimdhënësit i përgatisin planet dhe programet për punë si ato globale, tematike dhe ditore për orët mësimore duke i kushtuar vëmendje të veçantë qëllimeve edukative, arsimore dhe funksionale.

Programet e përgatitura si dhe puna e të gjithë arsimtarëve vëzhgohet dhe kontrollohet në mënyrë permanente nga shërbimi profesional.

Shkolla jonë ka bashkëpunim të mjaftueshëm me shkollat e komunës sonë. Kemi poashtu bashkëpunim permanent edhe me prindërit, edhe pse shumica e tyre janë jashtë vendlindjes, dhe pjesa e tjerër nuk janë të interesuar për kushtet e mësimin të fëmijëve të tyre. Mësimdhënësit në mënyrë të barabartë i trajtojnë nxënësit pa marrë parasysh përkatësin gjinore dhe sociale.

Prindët rregullisht informohen për suksesin dhe mungesat në forma të ndryshme përmes takimeve individuale, mbledhjeve prindore, dhe përmes porosive nga ditari elektronik. Këto fakte i kemi edhe nga informacionet e anketave të realizuara me prind ku 77% janë të kënaqur me sukseset dhe rezultatet e arritura në mësim, ndërsa 23 % nuk janë të kënaqur.

90% Deklarohen se nuk e kanë të organizuar kohën e lirë, kurse 10% Thuan se e kanë të organizuar.

Dhe në fund mund të arrijm në konkludim se nëqoftëse ka bashkëpunim të mirrëfilltë dhe koherent përmes këtyre organeve, sukcesi dhe efikasiteti i mësimin dhe nxënies do të jetë më i lartë.

PRIORITETET – të cilat mund të përfshihen në Planin zhvillimor të shkollës

- Trajnimi i mësimdhënësve për qasje sa më efikase për përmisimin e metodologjisë së planifikimit të mësimin.
- Trajnimi i mësimdhënësve për të punuar me nxënës me nevoja të ndryshme
- Të siguruarit e mjeteve materiale dhe vizuale;
- Sigurimi i mjeteve bashkëkohore, teknologjike;
- Sigurimi i teksteve shkollore në kohë të duhur.

- Sigurimi i lektyrave shkollore

LËMIA 4. PËRKRAHJA (MBËSHTETJA) E NXËNËSVE

Indikatorët

4.1 Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit

4.2 Shëndeti

4.3 Ndhimja këshilldhënëse për arsimin e mëtejshëm të nxënësve

4.4 Ndjekja e progresit (Përcjellja e përparimit)

Indikatorët: 4.1 Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit

Burimet e të dhënave:

Ligji për Arsim Fillor,

Statuti i shkollës,

Rregullorja për punë i Këshillit të shkollës,

Verbale nga Këshilli i shkollës,

Programa vjetore për punë të shkollës.

- Shkolla jonë me shërbimin pedagogjik, në bashkëpunim me mësimdhënësit e ciklit klasor e veçanërisht të klasave të para, bën përgatitjen për regjistrimin e fëmijëve për në shkollë përkatisht në muajin Maj. Në fillim bëhen shpalljet dhe pastaj oragnizohet shpërndarrja e këtyre shpalljeve. Pastaj merret lista e të lindurve për atë vit shkollor nga Ambulanta e shëndetit në Zhelinë, ku aty shihet pasqyra reale e fëmijëve që duhet regjistruar.
- Pastaj me fillimin e regjistrimit identifikohen dhe vlerësohen sjelljet dhe zhvillimet emocionale, sociale, fizike e intelektuale të fëmijëve.
- Për çdo fëmijë që konstatohet sjellje e veçantë emocionale, apo ndryshim fizik apo mental kërkohet nga prindërit vërtetim nga mjeku amë me qëllim që të ketë trajtim të veçantë nga arsimtarët.
- Shkolla angazhohet në çdo fillim të vitit shkollor të siguroj kushte elementare objektive për realizimin e punës edukativo – arsimore, por këtë vit shkollor ishte ndryshe pasi u bë sigurimi i klasave me banka dhe karrike të reja, tabela interaktive ku shkruhet me markera në të tre shkollat, pastaj në shkollën e fshatit Pallaticë u bë renovimi i tërësishëm i shkollës ku u siguruan kushte shumë të volitshme për realizimin sa më efikas të mësimin.

Indikatorët: 4.2 Shëndeti

Burimet e të dhënave:

Ligji për Arsim Fillor,
statuti i shkollës,
rregullorja për punë e këshillit të shkollës,
procesverbale nga këshilli i shkollës,
programa vjetore për punën e shkollës.

- Shkolla në mënyrë permanente kujdeset për shëndetin e nxënësve të të tre shkollave.
- Poashtu higjienës në shkollë i kushtohet rëndësi e veçantë.
- Shkolla poashtu kujdeset (në mungesë të logopedit) edhe për nxënësit me nevoja të veçanta, ku ata përfshihen në procesin e rregullt të mësimin, të vlerësimit dhe të marrjes së dëftesës,
- Pra nxënësit e identifikuar me dëmtime psiko-emocionale dhe mungesa e mjeteve material të prindërve ti dërgoj në shkolla të veçanta dhe mungesa e informacionit për të drejtat e fëmijëve, shkolla jonë i kyç në mësimin e rregulltë.
- Shkolla çdo vjet bën kontrollimin sistematik të nxënësve, dhe në rast të diagnostifikimit të ndonj sëmundje eventuale shkolla informohet për të, ku njëkohësisht njoftohet edhe prindi që të merren masa sa më shpejt.
- Poashtu nxënësit në mënyrë të rregullt bëjnë shiqimin sistematik te Stomatoologu në Tetovë duke filluar nga klasa e I e deri në klasën e VIII.
- Kemi edhe bashkëpunim të ndërsjellë me Ambulantën e përgjithshme në Zhelinë ku bëhet vaksinimi permanent i nxënësve, e vecanërisht vaksinimi i vajzave
- Poashtu bashkëpunimi është nivelin e duhur edhe me stacionin policorë të Grupçinit, ku edhe ata vazhdimisht mbajnë ligjëratat rreth përdorimit të mjeteve narkotike, alkoolit, duhanit, kalimit të rrugës me klasat e para si dhe vozitja e veturave pa i plotësuar kushtet (pa leje të vozitjes)

Indikatorët : 4.3 Ndhimja këshilldhënëse për arsimin e mëtejshëm të nxënësve

Burimet e të dhënave:

Kontroll të planit buxhetor, planit zhvillimor, kontroll të dokumentacionit për hapjen e tenderave, shpalljeve, anketave me arsimtar dhe prindër.

- Shkolla disponon me Program për orientimin profesional të nxënësve i cili realizohet në kontiunitet
- Drejtori i shkollës dhe shërbimi pedagogjik-psikologu i shkollës kanë Programe të veçanta për orientimin profesional
- Për punën e shkollës dhe suksesin e nxënësve, prindët i marrin informacionet përmes takimeve individuale dhe grupe me nxënësit, dhe përmes përfaqësuesve të Këshillit të prindërve, apo dhe përmes kontakteve individuale me prindë.
- Mësimdhënësit klasorë dhe ato lëndor në orët e klasave apo shkathtësive jetësore së bashku me psikologun e shkollës shtjellojnë dhe trajtojnë tema që i ngërthejnë më tepër nxënësit si ndalimi i përdorimit të mjeteve narkotike (duhani, alkooli, droga), koha e lirë pas mbarimit të procesit mësimor, dhe zakonisht të klasat e IX orientimi profesional ku nga ana e nxënësve bëhet zgjedhja e shkollës së mesme të preferuar.
- Çdoherë në fund të vitit shkollor, kemi vizitor apo përfaqësues të shkollave të mesme shtetërore dhe private që bëjnë promovimin e shkollave të tyre, u tregojnë nxënësve për kushtet dhe objektet shkollore, për mbarëvajtjen e procesit mësimor, për kuadrot mësimore, për mjetet që janë në përputhshmëri me teknologjinë Evropiane etj me qëllim që nxënësit të regjistrohen në këto shkolla.
- Ne kemi nxënës që regjistrohen edhe në shkolla private dhe që korrin suksese të mëdha, dhe poashtu viteve të fundit trend është bërë edhe nga vajzat ku bëjnë ndjekjen e mësimin fetar në Tetovë

Indikatorët: 4.4 Ndjekja e progresit (Përcjellja e përparimit)

Burimet e të dhënave:

Programa vjetore e punës së shkollës,
programi zhvillimor i shkollës,
raporti i vetevaluimit,
plan përcjelljen e planeve akcionale, anketa me arsimtar, prindër.

- Në shkollën tonë bëhet ndjekja e vazhdueshme e përparimit të nxënësve me anë të hospitimeve, kontrollimeve, analizave të ndryshme dhe në fund sjellja apo nxjerrja e përndimeve nëpërmjet krahasimeve të suksesit në periudha të caktuara, dhe njëkohësisht evitohen mangësit e rrjedhjes së procesit mësimor dhe të arriturat e nxënësve.
- Këto evidentime pastaj u tregohen si arsimtarëve, ashtu edhe prindërve me qëllim të ngritjes së vetëdijes së prindërve që edhe ata mund të ndikojn në suksesin e nxënësve.
- Gjithashtu arsimtarët në çdo orë bëjnë evidentimin e përparimit të nxënësve, ku mbajn rregullisht çeklista, dhe njëkohësisht nëse hasin raste kur nxënësit e shkëlqyeshëm dhe ata mesatr e lëshojn tepër mësimin për shkaqe të ndryshme, ato njoftojn prindërit dhe shërbimin pedagogjik që të merren masa sa më shpejt dhe mos shkaktohet probleme me regjistrimin e tyre në shkolla të mesme.
- Në rast se të kalimit të nxënësve nga një shkollë në tjetrën dhe anasjelltas, ku janë me numër të paktë por më tepër që migrojnë jashtë shtetit, shkolla evidenton të gjitha të dhënat në fletshpërnguljet e tyre.
- Nga shumica e tyre marrim informata kthyesë se ku janë të regjistruar, por nga të tjerët që shkojnë jashta vendlindjes shumë rrallë marrin informata kthyesë, dhe pastaj bëjm edhe ç’regjistrimin e tyre nga libri amë dhe nga ditari elektronik.
- Edhe në ditarin elektronik bëhet mbushja e të gjitha të dhënave nga arsimtarët si mbushja e orëve, mungesave, notimet e nxënësve, dhe kjo në mënyre koherente vëzhgohet nga shërbimi pedagogjik.
- Gjithashtu këtë vit rregullisht bëjm edhe ndjekjen e nxënësve në mënyre elektronike që janë në listën e paraparë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për ndihma sociale, ku në çdo tre muaj kërkohet evidentimi i mungesave të nxënësve.

Metodat e shfrytëzuara: Mbledhja e të dhënave (pyetësorë, anketime, vëzhgime)

Metoda dhe teknikat tjera të shfrytëzuara për mbledhjen e materialit	Subjekte të kyçur në mbledhjen e informacioneve	Informacionet e mbledhura																
Anketa me nxënës	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit	<p>Në pyetjen e nxënësve në anketim se: A i mbështet shkolla nevojat emocionale dhe sociale të nxënësve, 80% e tyre deklarohen se shkolla i mbështet nevojat emocionale dhe 20% mendojnë se shkolla nuk i mbështet.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th></th> <th style="text-align: center;">M</th> <th style="text-align: center;">F</th> <th style="text-align: center;">Gjithësej</th> <th style="text-align: center;">PO</th> <th style="text-align: center;">%</th> <th style="text-align: center;">JO</th> <th style="text-align: center;">%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;">Gjithësej</td> <td style="text-align: center;">50</td> <td style="text-align: center;">50</td> <td style="text-align: center;">100</td> <td style="text-align: center;">80</td> <td style="text-align: center;">80</td> <td style="text-align: center;">20</td> <td style="text-align: center;">20</td> </tr> </tbody> </table>		M	F	Gjithësej	PO	%	JO	%	Gjithësej	50	50	100	80	80	20	20
	M	F	Gjithësej	PO	%	JO	%											
Gjithësej	50	50	100	80	80	20	20											
Anketa me mësues	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit	<p>Në pyetjen e mësuesve se: A evidentohet përparimi i nxënësve në dokumentacionet adekuate shkollore 80% deklarojn se evidentohet përparimi i të arriturave të nxënësve, përkundër 20% ku deklarojn të kundërtën.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th></th> <th style="text-align: center;">M</th> <th style="text-align: center;">F</th> <th style="text-align: center;">Gjithësej</th> <th style="text-align: center;">PO %</th> <th style="text-align: center;">JO %</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;">Gjithësej</td> <td style="text-align: center;">15</td> <td style="text-align: center;">25</td> <td style="text-align: center;">40</td> <td style="text-align: center;">80</td> <td style="text-align: center;">20</td> </tr> </tbody> </table>		M	F	Gjithësej	PO %	JO %	Gjithësej	15	25	40	80	20				
	M	F	Gjithësej	PO %	JO %													
Gjithësej	15	25	40	80	20													
Pyetësor me prindë	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga prindërit	<p>Në pyetjen e prindërve në anketim se: A ju informon shkolla për shëndetin, suksesin dhe zhvillimit të fëmijës tuaj? 72% e prindërve ishin të kënaqur me mënyrën e informimit dhe 28% jo të kënaqur.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th></th> <th style="text-align: center;">Gjithësej</th> <th style="text-align: center;">PO</th> <th style="text-align: center;">%</th> <th style="text-align: center;">JO</th> <th style="text-align: center;">%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;">Gjithësej</td> <td style="text-align: center;">100</td> <td style="text-align: center;">72</td> <td style="text-align: center;">72</td> <td style="text-align: center;">28</td> <td style="text-align: center;">28</td> </tr> </tbody> </table>		Gjithësej	PO	%	JO	%	Gjithësej	100	72	72	28	28				
	Gjithësej	PO	%	JO	%													
Gjithësej	100	72	72	28	28													

Bisedë me drejtorin e shkollës	Ekipi për mbledhjen e të dhënave	<p>Para fillimit të vitit të ri shkollor plotësohen kushtet për fillimin normal dhe të mbarë të procesit mësimor, plotësohen nevojat e objekteve me ngrohjet në të tre shkollat, nevojat për rrjet stabil të internetit, mjeteve higjienike dhe që është më thelbësore pajisja e nxënësve me librat shkollor.</p> <p>Edhe në çdo fund vit shkollor bëhet shpërndarja e librave nga një nxënës në tjetrin, dhe njëkohësisht bëhet edhe porosia e librave të rinjë në mënyrë online, mirëpo ky process vitet e fundit ka shumë ngecje dhe nxënësit i pajisim me libra 90 % shkatruara.</p> <p>Prindërit dhe Këshilli i Shkollës rregullisht njoftohen për masat që duhet të ndërmerren për fillimin e vitit në vijim.</p>
--------------------------------	----------------------------------	---

Rezultatet e përmbledhura

Anët e forta

- Para fillimit të vitit të ri shkollor, në mënyrë të vazhdueshme krijohen kushte të volitshme për realizimin e procesit mësimor.
- Nga ana e shërbimit pedagogjik dhe ekipit për regjistrim të nxënësve bëhet identifikimi i nxënësve me nevoja të veçanta,
- Rregullisht bëhet vaksinimi i nxënësve,
- Rregullisht bëhet vizita te stomatologu,
- Bashkëpunimi në nivel me **Sektorin e Punëve të Brendshme Rajonale**
- Poashtu në mënyrë të rregulltë nga shërbimi policor në Grupçin mbahet ligjërata me tema të ndryshme që u takon nxënësve.
- Informimi i rregulltë i prindërve me aktivitetet të cilat po zhvillohen në shkollë.
- Në mënyrë të barabartë bëhet organizimi i aktiviteteve jashta mësimore me të gjithë nxënësit.
- Nuk ka diskriminim gjinor

Anët e dobëta

- Mungesa e ujit të mirë dhe të dezinfektuar për pije në të tre shkollat,
- Mungesa e mjeteve materiale punuese me nxënësit me nevoja të veçanta,
- Mungesa e trajnimeve të arsimtarëve për realizimin e procesit mësimor me këto nxënës,
- Mungesa e mjeteve materiale të shkollës për mbështetje dhe stimulim të arsimtarëve dhe nxënësve që arrijn rezultate të shkëlqyeshme etj.
- Bashkëpunim i dobët me organizatat joqeveritare të cilat i trajtojnë problemet e shëndetësisë dhe edukimit.
- Interesimi i dobët i prindërve për masa të mëtutjeshme të fëmijëve të tyre për t'i dërguar te stomatologu.

Analiza e rezultateve

Para fillimit të vitit shkollor në mënyrë të rregullt bëhet regjistrimi i nxënësve të klasave të para dhe shpërndarja e tyre nëpër klasa. Poashtu bëhet identifikimi në rast të ndonj sëmundje eventuale ku kërkohet vërtetim nga mjeku amë, që pastaj të ketë trajtim të mire nga mësimdhënësit.

Edhe pse që në klasë të pare kërkohet lista e vaksinave të marra nga lindja e tyre, pastaj bëhet rregullisht vaksinimi i tyre deri në fund të kryerjes së shkollimit fillor.

Kjo vlen njësoj edhe për stomatologun vazhdimisht bëhet ndjekja e shëndetit të nxënësve.

Për përparimin dhe suksesin e nxënësve në shkollë, si dhe për problemet dhe për mungesat e shumta prindërit informohen rregullisht. Mësimdhënësit klasor në çdo tremujorë përgatisin fleta vlerësuese të nxënësve dhe raporte statistikore ku fletat ua shpërndajn prindërve dhe statistikën tre mujore shërbimit pedagogjik ku bën pastaj krahasimin e vlerësimit dhe atë arriturat e nxënësve.

PRIORITETET – të cilat mund të përfshihen në Planin zhvillimor të shkollës

- Përmisimi i informimit të arsimtarëve dhe prindërve për vendimet e Këshillit të shkollës.
- Sigurimi i kushteve optimale për realizimin e punës mësimore me nxënës duke i inkuadruar edhe ata me nevoja të veçanta,
- Trajnime të arsimtarëve për aplikimin e formave dhe metodave bashkëkohore të punës mësimore me nxënësit me nevoja të veçanta
- Të krijohet mundësia që nxënësit në mënyrë të rregulltë të bëjnë shqimin sistematik të dhëmbëve te Stomatologu i fshatit, dhe jo të enden te shërbimi stomatologjik në Tetovë.
- Zmadhimi i fondit të bibliotekës së shkollës
- Bashkëkohëzimi i mjeteve ndihmëse mësimore

LËMIA 5. *Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë*

Indikatorët

5.1 *Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë*

5.2 *Promovimi i arritjeve*

5.3 *Barazia dhe drejtësia*

5.4 *Raporti i partneritetit me prindërit dhe me komunitetin lokal dhe afarist*

Indikatorët : 5.1 *Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë*

Burimet e të dhënave:

Programa vjetore e punës së shkollës,

programa e punës së drejtorit të shkollës,

raportet vjetore për punë i shkollës, anketa me arsimtarë,

programa për punën e psikologut, verbale nga mbledhjet e Këshillave arsimore.

- Marrëdhëniet ndërmjet të punësuarve në kolektiv janë harmonike, marrëdhëniet e arsimtarëve dhe nxënësve janë poashtu në nivel të duhur . Në kolektiv respektohet kodeksi etik i sjelljes dhe vlerësimit të të arriturave të nxënësve, respektohet barazia gjinore në mes nxënësve dhe të punësuarve etj
- Në shkollë kemi rregulla për sjellje - KODEKS të sjelljeve të nxënësve, arsimtarëve dhe të punësuarëve tjerë
- Gjatë vitit shkollor me qëllim të mbajtjes së rendit shkollor organizohet kujdestari nga ana e arsimtarëve lëndor, arsimtarëve klasor dhe nxënësve të klasave të cikleve të larta, ku të njëjtit mbajnë shënime të përditëshme për hyrje dhe dalje të personave të ndryshëm në shkollë.
- Sipas të dhënave nga anketimi me nxënës rreth raporteve të ndërsjellta në mes tyre konstatojm se shumica e nxënësve kan komunikimin të mirë mes veti, bile edhe me nxënësit e shkollës periferike ku bashkarisht marrin pjesë në gara të ndryshme në lëndë të ndryshme.
- Por dominojn garat sportive ku pjesmarrja është masive ndërmjet të dy gjinive dhe të dy shkollave (në të gjitha sportet), dhe pastaj fituesit më të mirë marrin pjesë edhe në gara të tjera me shkollat tjera komunale, dhe me shkollën tjetër “Jahja Qemal”, ku kemi ftesë çdoherë nga ana e tyre për pjesmarrje në gara të ndryshme.

- Në lidhje me sjelljen, disiplinën, dhe me mungesat e shumta të nxënësve çdo vit shkollor janë evidente, por shkolla mundohet çdoherë ti tejkaloj më mirë me mundësit e veta, por shumë pak ka ndihmë nga prindët në këtë këndvështrim.
- Si më aktuale (prezente), janë vonesat në mësim, ikjet nga orët e fundit mësimore, pirja e duhanit, notat e dobëta (mbi 5), përdorimi i celularëve dhe mosrespektimi i rendit shtëpiak të shkollës.
- Në rastet më të rënda të shkeljeve drastike Këshilli i arsimtarëve në mënyrë unanime merr masa pedagogjike (vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim, ndërrim të klasës, të shkollës etj.

Indikatorët: 5.2 Promovimi i arritjeve

Burimet e të dhënave:

Anketat me arsimtar, nxënës dhe prindër, verbale nga bashkësia e nxënësve

- Shkolla vazhdimisht bën prezentimin e rezultateve të nxënësve në forma të ndryshme, përmes takimeve me prindë, konfirmimi i suksesit në tremujor, gjysëmvetor, tre mujori i dytë dhe fundi i vitit shkollor, dhe përmes formave elektronike.
- Poashtu bëhet edhe informimi i prindërve që ndjekin rrjetin social (facebook), garat shkollore të organizuara në kuadër të lëndëve të ndryshme mësimore, programeve artistike, lajmërimeve të ndryshme për shënimin e ndënjë date të rëndësishme me karakter kulturor, historik etj. Kemi psh rastin me festën e 28 Nëntorit, festën e Abetares, Patronati i Shkollës, krosi komunal, promovimi i tre librave etj ku kemi pjesëmarrje masive të prindërve, dhe ku prindët vazhimisht tregojn interesim dhe japin përkrahje morale dhe materiale.
- Mirëpo në inkorporimin e fëmijëve me nevoja të veçanta pas mësimi të rregulltë është shumë vështirë edhe të kyçen në aktivitetet e lira jashta mësimore apo manifestime të ndryshme.
- Në pyetjen e arsimtarëve : Nxënësit me probleme fizike, psiko – emocionale a e vështirësojn procesin edukativ arsimor kemi fituar këto deklarime 77% deklarojn se po e vështirësojn procesin e rregulltë mësimor dhe 23 % deklarohen se nuk e pengojn.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Poashtu edhe në pyetjen e prindërve se Ai mbështet shkolla të gjithë nxënësit njësoj? 66 % deklarojn se PO shkolla i mbështet nxënësit njësoj në aktivitete të ndryshme dhe 34% deklarojn se nuk i mbështet.
--	--

<i>Indikatorët: 5.3 Barazia dhe drejtësia</i>
--

<p>Burimet e të dhënave:</p> <p>Programa vjetore për punë e shkollës, evidenca pedagogjike, verbale nga mbledhjet e mbajtura prindore, memorandum për bashkëpunim me institucionet tjera arsimore, evidenca e dokumentacionit arkivor të shkëmbimit të letrave, anketat me prindër, arsimtar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Nxënësit dhe prindërit kanë njohuri për drejtat e fëmijëve, ➤ Në orën e kujdestaris përpunohen tema nga programa e Shkathtësive jetësore ku trajtohen tema nga barazia gjinore dhe drejtësia. ➤ Pasi kemi nxënës me aftësi të ndryshme psiko-fizike, arsimtarët kanë kujdes dhe principe për barazi dhe drejtësi ndaj të gjithë nxënësve , ➤ Psikolog-ja e shkollës mban ligjërata për barazi dhe drejtësi ➤ Psikolog-ja e shkollës vazhdimisht trajton tema me nxënësit si Njohja e të drejtave të mia, ➤ Në bashkëpunim me arsimtaren e arsimit qytetar psikolog-ja mban ligjëratë lidhur me korupcionin ➤ Shkolla gjithmon tenton të siguroj rrethin e shëndosh dhe të ketë raporte të mira ndërmjet nxënësve dhe arsimtarëve pa marrë parasysh gjininë ose ndryshimin në aftësi gjatë punës së përditëshme.
	<p style="text-align: center;"><i>Indikatorët: 5.4 Raporti i partneritetit me prindërit dhe me komunitetin lokal dhe afarist</i></p>
	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Me prindërit e nxënësve problematik, mungesat paarsyeshme, shërbimi pedagogjik-psikologjik dhe kujdestarët a klasave mbajn takime të përhershme, por shumë pak prindë tregojn interesim në këtë sferë dhe ftesës për këshillime nga ana e psikologes shumë pak i përgjigjen. ➤ Edhe pse këto këshillime mund të ndikojn në mënyrë pozitive tek prindët dhe pastaj tek nxënësit, ku ne presim

përmisim të gjendjes së atyre nxënësve.

- Me punën dhe atmosferën shkollore prindërit në përgjithësi janë të kënaqur. Në pyetjen e prindërve se a jeni të kënaqur me bashkëpunimin 85% deklarojn se janë të kënaqur dhe 15% nuk janë.
- Mirëpo kur kemi parasysh faktin se gjendja arsimore e prindërve në këtë rreth është shumë a palakmueshme pasi 50 % e tyre janë me arsim fillor, 25 % me arsim të mesëm dhe 25 % me arsim të lartë (fakultet) është shumë vështirë të arrihet një bashkëpunim i ndërsjellë në këtë segment.
- Poashtu kohën e fundit është trend edhe migrimi i familjeve të shumta, dhe kjo ndikon negativisht në interesimin e prindërve për shkollim, ndikon negativisht tek nxënësit për mësim, pasi edhe ata mendojnë se një ditë detyrimisht do të migrojnë në vende tjera.
- Bashkëpunimi me institucionet publike shëndetësore është në nivel ku bëhet vazhdimisht vizita tek këto institucione ku kemi për qëllim kujdesin dhe shëndetin e nxënësve, me Ambulantën në Zhelinë, Stomatologun në Tetovë,
- Kemi bashkëpunim të mirëfillt me Bashkësinë Vendore të të tre fshatrave ku shtrihet shkolla jonë, në suaza të obligimeve ligjore formale, ku vazhdimisht thirren për pjesëmarrje në çdo eveniment të shkollës.
- Shkolla ka bashkëpunim të mirë me sektorin privat afarist por nuk realizojmë mësim praktik.
- Poashtu kemi bashkëpunim të mirë edhe me Komunën e Zhelinës, ku vazhdimisht kërkojmë mbështetje materiale,

Metodat e shfrytëzuara: Mbledhja e të dhënave (pyetsorë, anketime, vëzhgime)

Informacionet e mbledhura

Metodat dhe teknikat tjera të shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave	Subjekte të kyçur në mbledhjen e informatave																									
Anketa me nxënës	Ekipi për mbledhjen e dhënave nga nxënësit	<p>Në pyetjen e nxënësve a thua raportet ndërmjet vet nxënësve bazohen në respektimin e ndërsjellë, 94% e tyre mendojnë se PO ekziston respektimi i ndërsjellë dhe 6% e tyre mendojnë Jo nuk ekziston respektim ndërmjet nxënësve.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th></th> <th>M</th> <th>F</th> <th>Gjithësej</th> <th>PO %</th> <th>JO %</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Gjithësej</td> <td style="text-align: center;">50</td> <td style="text-align: center;">100</td> <td style="text-align: center;">100</td> <td style="text-align: center;">94</td> <td style="text-align: center;">6</td> </tr> </tbody> </table>		M	F	Gjithësej	PO %	JO %	Gjithësej	50	100	100	94	6												
	M	F	Gjithësej	PO %	JO %																					
Gjithësej	50	100	100	94	6																					
Anketa me mësimitdhënës	Ekipi për mbledhjen e dhënave nga mësimitdhënësit	<p>Në pyetjen e mësimitdhënësve A i mbështet shkolla të gjithë nxënësit njësoj? 90% e mësimitdhënësve kanë deklaruar se shkolla i mbështet të gjithë nxënësit njësoj pa marrë parasysh faktet material, emocionale etj, dhe 10% e deklarojn të kundërtën.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th></th> <th>M</th> <th>F</th> <th>Gjithësej</th> <th>PO %</th> <th>JO %</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Gjithësej</td> <td style="text-align: center;">15</td> <td style="text-align: center;">25</td> <td style="text-align: center;">40</td> <td style="text-align: center;">90</td> <td style="text-align: center;">10</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në pyetjen e mësimitdhënësve a i mbështet shkolla të gjithë mësimitdhënësit njësoj? 78% e mësimitdhënësve deklarojn se shkolla i mbështet të gjithë mësimitdhënësit njësoj, dhe 22% nuk i mbështet.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th></th> <th>M</th> <th>F</th> <th>Gjithësej</th> <th>PO %</th> <th>JO %</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Gjithësej</td> <td style="text-align: center;">15</td> <td style="text-align: center;">25</td> <td style="text-align: center;">40</td> <td style="text-align: center;">78</td> <td style="text-align: center;">22</td> </tr> </tbody> </table>		M	F	Gjithësej	PO %	JO %	Gjithësej	15	25	40	90	10		M	F	Gjithësej	PO %	JO %	Gjithësej	15	25	40	78	22
	M	F	Gjithësej	PO %	JO %																					
Gjithësej	15	25	40	90	10																					
	M	F	Gjithësej	PO %	JO %																					
Gjithësej	15	25	40	78	22																					

Pyetësor për prindë	Ekipi për mbledhjen e dhënave nga prindërit	<p>Në pyetjen e prindërve se A i mbështet shkolla të gjithë nxënësit njësoj? 66% kanë deklaruar se Po shkolla i mbështet të gjithë nxënësit njësoj dhe 34% se JO nuk i mbështet.</p> <table border="1" data-bbox="1016 245 1733 384"> <thead> <tr> <th></th> <th></th> <th>Gjithësej</th> <th>PO %</th> <th>JO %</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Gjithësej</td> <td>100</td> <td>100</td> <td>66</td> <td>34</td> </tr> </tbody> </table>			Gjithësej	PO %	JO %	Gjithësej	100	100	66	34
		Gjithësej	PO %	JO %								
Gjithësej	100	100	66	34								
Bisedë me prindë	Ekipi për mbledhjen e dhënave	<p>Në bisedën e realizuar me prindët konstatojm se ato rregullisht marrin informacione për nxënësit si për suksesin ashtu edhe për problemet tjera që shkaktohen në procesin e mësimin, dhe se shumica e tyre nuk bashkëpunojn me shkollën për arsye të punëve të shumta të tyre private, disa punojn jashtë vendlindjes etj.</p> <p>Dhe shumica e tyre shumë pak ndjekin suksesin dhe mungesat përmes ditarit elektronik.</p>										
Bisedë me përfaqësues të B.V – Trebosh, Pallaticë, dhe Ozumishtë	Ekipi për mbledhjen e dhënave nga bashkësia vendore e tre vendbanimeve	<p>Nga biseda me kryetarët e të tre Bashkësive Vendore të të tre vendbanimeve ku shtrihet shkolla arrijm në përfundim se shkolla relativisht ka raporte të mira me të gjithë këto bashkësi, ku edhe shumicën e rasteve kërkohet edhe ndihma e tyre qoftë material për ndërtimin e diçkaje (nëqoftëse nevojitet), dhe poashtu edhe ndihma morale me shumë efikasitet në realizimin e procesit mësimor, si zgjidhjen e probleme në zgjedhjen e kuadrit mësimor.</p> <p>Është me rëndësi të thuhet se në renovimin e objektit të shkollës periferike të fshatit Pallaticë bashkëpunimi me Bashkësin Vendore ka qenë në nivel të shkëlqyer, ku kemi pasur mbështetje të fortë morale në realizimin e këtij projekti.</p>										
